
04/02/2021

Shenjtori i ditës: Oshënar Isidor Pilusioti – Oshënar Nikolla Studiti



E enjte, 4 shkurt 2021 – Shenjtori i ditës.

Oshënar Isidor Pilusioti. Dëshmor Theoktisti. Oshënar Jasim çudibërësi. Oshënar Nikolla Studiti.

– Oshënar Isidor Pilusioti –

Oshënar Isidori lindi në një familje të madhe fisnike të Aleksandrisë, lidhjet e së cilës përfshinin edhe patriarkun Theofil dhe nipin e tij, shën Kirilin. Ai ndoqi një shkollim të shkëlqyer shekullar, po ashtu edhe në theologji, në shkollat e famshme të Aleksandrisë. Oshënari ishte nxënës besnik i mësimit të Etërve, veçanërisht i shën Joan Gojartit dhe konsiderohet nga shumë si dishepull i tij.

Për një kohë të shkurtër oshënar Isidori dha mësim retorikën në Pelusium, në lindje të Deltës së Nilit. Por shpejt, dashuria e tij për gjërat e Perëndisë e bëri që të braktiste shkëlqimin e kësaj jete të përkohshme dhe të tërhiqej në shkretëtirën e Nitrisë.

Pas një viti asketizmi, shqetësimi për ndërtimin shpirtëror të Kishës e detyroi që të kthehej në Pelusium, ku u dorëzua prift nga episkopi Amona, i cili e ngarkoi t'u jepte mësim besimtarëve dhe katikumenëve. Talenti i tij në retorikë dhe njohja e thellë e Shkrimit të Shenjtë, që e kishte fituar në jetën hezikaste, i dhanë famën e një mësuesi të madh në mbarë Egjiptin dhe shumë paganë e judenj u kthyen në të krishterë prej tij.

Kur u dorëzua episkop i ri i Pelusiumit (413), Evsevi ushtroi një trysni të madhe në Kishë, kështu që Isidori u detyrua të arratisej përsëri në shkretëtirë. Ai u tërhoq në një manastir pranë Afneonit, ku kaloi pjesën tjetër të jetës në vetmi. E vetmja veshje e tij ishte një tunikë prej leshi të ashpër, barishtet e gjethet, ushqimi i tij; ishte një imitim i vërtetë i jetës së shën Joan Pagëzorit. I parë nga të gjithë si modeli i jetës së virtytshme dhe i dijes së Perëndisësi një llambë në llambadar që përhap dritë mbi të gjithë, shën Isidori, duke mos pyetur për persekutimin dhe urrejtjen e njerëzve të botës, i mësoi të tjerët me autoritet për shumë vjet me anë të letrave të tij të thella dhe plot dituri, prej të cilave kanë mbijetuar më tepër se dy mijë.


Personat që kishin letërkëmbim me të, i përkisnin të gjitha shtresave dhe ai u jepte përgjigje me shumë dallueshmëri e kuptim shpirtëror. Shpjegonte çështje të Shkrimit të Shenjtë, tregonte gabimet e interpretimit që bënin hebrenjtë dhe qartësonte misteret e Trinisë së Shenjtë dhe të Bërjes Njeri të Zotit, duke i mposhtur në këtë mënyrë arianistët, nestorianët dhe sabelianët, si dhe të gjithë heretikët e tjerë. Ai e shpjegonte lartësinë e priftërisë me tone lirike dhe qortonte episkopë, priftërinj, dhjakë e murgj, sjellja e të cilëve ishte e padenjë për thirrjen e tyre. Pa marrë parasysh postin politik, qortonte magjistratë, guvernatorë, madje edhe vetë perandorin Theodhos II (408-50), duke u rikujtuar atyre detyrimet ndaj popullit të Perëndisë dhe Kishës së Shenjtë. Duke mos e toleruar aspak paudhësinë, frymëzonte dashurinë për drejtësinë dhe mirëbërjen dhe, ndërsa nuk kishte fare lidhje me këtë botë, ai gjykonte dhe vendoste me shumë autoritet edhe për çështje të saj.

Kur shën Kirili u bë patriark i Aleksandrisë, nuk pranoi të kujtonte emrin e shën Joan Gojartit në diptikë gjatë Liturgjisë Hyjnore, duke ndjekur këshillën e pamatur të ungjit të tij, Theofilit. Shën Isidori i shkroi një letër të fortë, duke i kujtuar se, për të

pasur një gjykim të drejtë, Perëndia vetë na ka mësuar të mos u vëmë veshin fjalëve dhe thashethemeve apo paragjykimeve tona. Kjo letër, e ndjekur nga një zbulesë hyjnore, ndryshoi plotësisht mendjen e shën Kirilit. Ai jo vetëm që e vendosi emrin e kryepiskopit të Konstandinopojës në diptikë, por edhe u bë një prej mbrojtësve më të mëdhenj të nderimit të shenjtorit.

Disa vite më vonë (433), Isidori, pasi vuri re tonin e ashpër të debatit mes shën Kirilit dhe patriarkut Joan të Antiokisë, që pasoi me dënimin e Nestorit në Sinodin e Efesit, i shkroi atij duke e nxitur të bënte lëshime të arsyeshme për hir të paqes. “Si ati yt, meqë të pëlqen të më thërrasësh në këtë emër, ose më mirë si biri yt, të lutem t’i japësh fund mosmarrëveshjes, sepse do të ndodhë një përçarje e përhershme nën pretekstin e besimit”.

Ushtrimi i një autoriteti të tillë, të ngjashëm me atë të profetëve të hershëm, ndërsa ishte diçka e pranueshme për njerëz të Perëndisë si shën Kirili, solli persekutime të shumta ndaj shën Isidorit. Thuhet se edhe e kanë dëbuar nga shkretëtira e tij. Ai qëndroi i palëkundur në të gjitha mundimet, me gjithë problemet e mëdha që e shqetësonin Kishën në atë kohë. Ishte i bindur se ne fitojmë jetën e përjetshme, sepse Kisha na parapërgatit për lavdinë e saj të ardhshme nëpërmjet mundimeve të Kryqit. Kështu, rreth vitit 449, e priti vdekjen si çliruese dhe si kurorëzim të përpjekjeve të tij shumëvjeçare.



* * * * *

– Oshënar Nikolla Studiti –

Oshënar Nikolla lindi në Kidoni të Kretës, në vitin 793. Në moshën 10 – vjeçare prindërit e dërguan në Konstandinopojë, për t'u bashkuar me ungjin e tij, që ishte murg i Studionit. Në këtë vend përfitoi shumë prej mësimit të shën Theodhorit (11 nëntor) dhe u bë nxënës i tij shembullor për gjithë jetën. Ai u rrit në virtyt e në urtësi dhe, pasi mori qethjen murgërore, u bë shkruesi personal i shën Theodhorit. I vdekur për vullnetin e tij vetjak, ai jetonte vetëm për Krishtin, që ishte i pranishëm në personin e atit të tij shpirtëror dhe ishte një anëtar i përulur e punëtor i komunitetit murgëror ku jetonte.

Ndërsa zbriste akoma më shumë në thellësinë e përulësisë, zjarri i dashurisë hyjnore konsumonte/dobësonte pasionet trupore dhe nevojat natyrore të trupit. Përmbajtja, agripnitë, qetësia dhe lutja e tij e vazhdueshme tërhoqën admirimin e të gjithë bashkëmurgjve. Ata e dorëzuan prift, të detyruar vetëm nga përulësia e tij.

Shenjti jetonte në paqe në manastir, sikur të ishte në parajsë tokësore, brenda dritës së mësimdhënieve të shën Theodhorit, kur perandori ikonoklast Leon V Armeni nisi një persekutim të ri (815). Komuniteti i Studionit u shpërnda dhe Theodhorin e internuan në fortesën e Metopas në Helespond, i ndjekur nga Nikolla, që bashkëndau me dëshirë keqtrajtimet dhe privimet e atit të tij shpirtëror. Ai kujdesej për të dhe transkriptonte shkrimet e tij, të cilat ua dërgonte fshehurazi nxënësve të shpërndarë. Këto shkrime ishin një mbështetje e fortë për çështjet orthodhokse.

Njëherë, kur kapën një prej letrave të Theodhorit, u bë e qartë për perandorin se internimi i studitëve ishte kthyer në avantazh për ta dhe urdhëroi që të dy pohuesit e besës të kamxhikoheshin pa mëshirë. Të gjakosur dhe gjysmë të vdekur mbi tokën e ngrirë, ata u shëruan duke i mjekuar plagët njëri-tjetrit me rreckat që u jepnin gardianët. Pas kësaj i internuan në fortesën e largët të Bonitës dhe më vonë afër Smirnës, ku u mbyllën në burg dhe vuajtën nga uria pothuajse deri në vdekje.

Pas vdekjes së Leonit V, më 820, Mihaili II, perandori i ri edhe pse ikonoklast, i la të lirë pohuesit e besës. Theodhori dhe Nikolla e bënë më këmbë rrugën deri në Konstandinopojë, por, meqenëse me anë të një dekreti perandorak iu ishte mohuar hyrja në qytet dhe në manastirin e tyre, ata kërkuan strehë në Halkidonë. Atje u gëzuan kur takuan patriarkun Niqifor (2 qersh.), i cili i vlerësoi jashtë mase shenjat dhe të djegurat që kishin në trupin e tyre, njësoj si shenjat e Pësimit të Zotit tonë (shih Gal. 6:17). Ata jetuan për disa kohë në manastirin e Shën Trifonit në kepin Akritas, pastaj shkuan në ishullin e Prinkipos, ku më 11 nëntor 826 shën Theodhori ia dorëzoi shpirtin e tij Zotit. Shën Nikolla, duke qenë nxënës besnik i mësuesit të tij edhe pas vdekjes, ndërtoi një banesë pranë varrit të tij dhe jetoi aty me kreshmë, agripni dhe lutje.

Gjatë persekutimit të egër në kohën e perandorit Theofil (829-842), murgjit u shpërndanë përsëri dhe iu nënshtruan keqtrajtimeve të shumta mizore. Shën Nikolla gjeti strehë në Firmopolis, një lagje evropiane e Konstandinopojës, në pronën e një gruaje të devotshme, që u bë me të vërtetë filial i manastirit të Studionit.

Pas vdekjes së tiranit, kur Orthodhoksia po rimëkëmbej në saje të kujdesit të

perandoreshës së devotshme Theodhora dhe të patriarkut Metod, pohuesit e besës ia dolën mbanë të ktheheshin në Konstandinopojë dhe në manastiret e tyre. Studitët, me në krye shën Nafkratin (18 prill), arritën ta lulëzonin përsëri manastirin e tyre, njësoj si në kohën e shën Theodhorit.

Më pas, kur lipsani i shën Theodhorit u kthye në Studion (shih 26 jan.), shën Nikolla u kthye atje dhe jetoi një jetë të mbyllur e të bekuar në mes të komunitetit. Por, kur fjeti shën Nafkrati, vëllezërit këmbëngulën që të bëhej ai igumeni i tyre i ri. Pas tre vjetësh, meqenëse i pëlqente më tepër qetësia, ai caktoi Sofronin e virtytshëm pasues të tij dhe vetë shkoi të jetonte si eremit në Firmopolis (850). Megjithatë, kur Sofroni vdiq, vëllezërit erdhën përsëri tek ai për t'i kërkuar atit të tyre që të kthehej. Largimi i patriarkut Ignat nga froni për shkak të mospranimit të martesës së Mihailit II për shkaqe antikanonike dhe trazirat që shkaktoi në Kishë zgjedhja e shën Fotit, u bënë shkak për mundime të reja për shën Nikollën adhuruesin e qetësisë. Duke e parë si të pavlefshme ngritjen e papritur të një laiku në rangun e patriarkut, Nikolla zgjodhi të jetonte në Prenetos, filial i manastirit të Studionit në gjirin e Nikomedisë. Atje e vizitoi edhe perandori, që donte ta bindte të pranonte situatën e re.

Por shenjti nuk pranoi. I dëbuar nga banesa e tij, shkoi të gjente strehë në Konstandinopojë, në shtëpinë e një bamirësi të pasur, të cilën e transformoi në manastir. I ndodhur në presion të vazhdueshëm për të pranuar shën Fotin dhe duke mos dashur të sillej kundër ndërgjegjes së tij, e la këtë vend për të shkuar në ishullin Prokonesus dhe nga atje për në Mitilini e më pas për në Kersonë. Pas 7 vjetësh u soll me forcë në Studion dhe qëndroi atje si i burgosur, duke provuar për dy vjet shumë keqtrajtime, derisa erdhi në fron Vasil Maqedonasi (867-886). Ai e caktoi Ignatin në fronin patriarkal dhe u përpoq të bindte Nikollën të pranonte përsëri igumeninë e manastirit të Studionit. Por shenjtori ishte i sëmurë dhe i thyer në moshë; preferoi të qëndronte larg nga shqetësimet njerëzore, duke u përgatitur për banesën e përjetshme, që e gjeti më 4 shkurt 868, në moshën 75-vjeçare.

Nëpërmjet përpjekjeve asketike dhe mohimit të vazhdueshëm të dëshirës së tij, shën Nikolla arriti të mposhtte mentalitetin mishor dhe e ofroi veten si një instrument i butë i Hirit, i cili kreu shumë mrekulli me anë të tij. Ai shëroi Evdhoksinë, gruan e perandorit Vasil, dhe Helenën, gruan e patricit Manuel, duke iu shfaqur atyre në ëndërr. Ai ua tregonte të ardhmen në mënyrë profetike atyre që vinin për ta takuar dhe paratha ditën e largimit të tij nga kjo botë. Shën Nikolla i thirri murgjit pranë vetes dhe i pyeti nëse kishin nevojë për ndonjë gjë. "Grurë!" u përgjigjën ata. Atëherë ai u tha atyre: "Ai që ngushëlloi Egjiptin në shkretëtirë, do t'ju dërgojë grurë me bollëk në tri ditë". Dhe me të vërtetë, tri ditë më vonë pas

prehjes së shenjtorit, një anije me grurë, e dërguar nga perandori Vasil, mbërriti në portin e manastirit.

— facebook.com/koash1991